



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

VENDIM

“Mbi korrigjimin e vendimit nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci.”

Roland Ilia	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Olsi Komici	Relator

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Trupi gjykues u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes, z. Olsi Komici, për korrigjimin e gabimit material në vendimin nr. 114, datë 11.03.2019, për subjektin e rivlerësimit Dritan Seci.

Në vendimin nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konkretisht, në faqen e fundit të tij (faqe nr. 42), në dispozitivin e vendimit, në përbërjen e trupit gjykues, është bërë një gabim material në cilësimin e komisionerëve.

Me vendimin nr.1, datë 21.03.2018, është zgjedhur si kryesues i trupit gjykues, komisioneri Roland Ilia, ndërsa në vendimin e publikuar, në pjesën “Vendosi:”, gabimisht është përcaktuar në cilësinë e kryesuesit, komisionere Valbona Sanxhaktari, kurse komisioner Roland Ilia në atë të anëtarit.

Trupi gjykues, pasi konstatoi se kërkesa e relatorit qëndron dhe pasaktësia është e dukshme, si pasojë e një gabimi material,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin në pjesën “Vendosi:” të vendimit nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të emrit të kryesuesit të trupit gjykues nga Valbona Sanxhaktari në Roland Ilia.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe vëzhguesin ndërkombëtar për këtë korrigjim.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona Sanxhaktari

Roland Ilia

Olsi Komici

Anëtare

Kryesues

Relator

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha